

**BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

Projekt – Rregullore

“Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”

Miratuar me vendimin nr. , datë të Këshillit Mbikëqyrës

**Kreu I
Të përgjithshme**

**Neni 1
Objekti**

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave kryesore mbi përmbajtjen, formën dhe mënyrën e llogaritjes dhe të raportimit që bankat dhe degët e bankave të huaja duhet të përmbushin për një administrim sa më të përshtatshëm të likuiditetit.

**Neni 2
Subjektet**

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja të cilat ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë. Këto subjekte në vijim për thjeshtësi, në këtë rregullore, do të quhen “banka”.

**Neni 3
Baza ligjore**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të nenit 66 të ligjit nr. 9662, datë 18.12. 2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

**Neni 4
Përkufizime**

Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e përdorur kanë të njëjtin kuptim si në nenin 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat

në Republikën e Shqipërisë", ndërsa termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

1. "Likuiditeti" është aftësia e bankave, për të siguruar në cdo kohë burime fondesh të mjaftueshme dhe me kosto të përshtatshme, për të përmbushur detyrimet e tyre.
2. "Rreziku i likuiditetit" është mundësia, që banka të mos përballojë në mënyrë eficiente rrjedhjet aktuale dhe të ardhshme të parasë, ato të parashikuara apo të paparashikuara, si dhe kërkesat për kolateral, pa ndikuar në operacionet ditore, apo në gjendjen financiare të saj (bankës).
3. "Kushte të jashtëzakonshme" janë ato situata në të cilat ekziston një kërcënim real që mund të çojë bankën në paaftesi paguese duke mos mundur kështu të shlyejë detyrimet e saj kur ato maturohen.
4. "Plani i emergjencës" është një dokument i hartuar nga banka, në të cilin pasqyrohen rregullat dhe procedurat që duhen ndjekur në kushte të jashtëzakonshme si dhe procedurat për mundësimin e fondeve të emergjencës.
5. "Fluksi neto i parase" është diferenca ndërmjet flukseve hyrese dhe flukseve dalese për një periudhë të përcaktuar kohe duke u reflektuar kështu në rritje apo ulje të sasise së *cash*-it .
6. "Maturiteti kontraktual i mbetur i të drejtave dhe detyrimeve", është periudha e mbetur deri në përfundimin e afatit kontraktual të tyre.
7. "Përqendrimi në burimet e financimit" është gjendja kur një vendimmarrje e vetme apo një faktor i jashtëm i vetëm mund të shkaktojë tërheqje të menjehershme dhe të konsiderueshme të fondeve, duke detyruar kështu bankën të ndryshojë ndjeshëm strategjinë e saj të financimit.
8. "*Stress-testing*" është teknike e administrimit të rrezikut e përdorur për të vlerësuar ndikimin e mundshëm të një ose më shumë faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm mbi qëndrueshmërinë financiare dhe/ose likuiditetin e bankës. *Stress testet* mund të përfshijnë analiza të skenareve apo analiza të ndjeshmerisë.

Kreu II

Sistemet e administrimit të rrezikut të likuiditetit

Neni 5

Struktura organizative për administrimin e rrezikut të likuiditetit

1. Banka krijon strukturë organizative të përshtatshme për administrimin e rrezikut të likuiditetit, e cila përcakton qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e njësive organizative të bankës që realizojnë monitorimin dhe administrimin e rrezikut të likuiditetit.
2. Struktura siguron ndarjen e përgjegjësive ndërmjet funksioneve të matjes dhe të monitorimit të rrezikut të likuiditetit, me qëllim parandalimin e konflikteve të mundshme të interesit. Ajo duhet të përcaktojë qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e njësive që realizojnë sigurimin e fondeve të financimit.
3. Këshilli drejtues i bankës, për qëllim të administrimit të rrezikut të likuiditetit:
 - a. merr në shqyrtim dhe aprovon strategjinë dhe politikën/a të administrimit të rrezikut të likuiditetit dhe monitoron zbatimin e tyre, duke përfshirë aprovimin dhe monitorimin e planit të emergjencës;
 - b. rishikon përshtatshmërinë e politikave të zbatuara minimalisht në frekuenca vjetore;
 - c. aprovon kufijtë e brendshëm të ekspozimit për rrezikun e likuiditetit në përputhje me profilin e saj të rrezikut, strategjinë e biznesit dhe rolin e saj në sistemin financiar;
 - d. rishikon raportin për administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe kryen verifikimin e shmangieve nga politikat e miratuara;
 - e. merr në shqyrtim rezultatet e gjeneruara nga *stress testet* dhe përcakton në përputhje me keto të fundit masat për rregullimin e profilin të likuiditetit në përputhje me tolerancën e rrezikut;
 - f. sigurohet, që njësia përgjegjëse (komiteti) administron rrezikun e likuiditetit në mënyrë efektive
 - g. vlereson dhe monitoron efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm për administrimin e rrezikut të likuiditetit.
4. Komiteti i administrimit të rrezikut, krahas administrimit të rreziqeve të tjera të subjektit, është përgjegjës edhe për administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe realizon në funksion të këtij të fundit:
 - a. hartimin, zbatimin dhe monitorimin e strategjisë, politikave dhe procedurave për administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe dhënien e propozimeve për rishikimin e tij;
 - b. zhvillimin dhe vlerësimin e sistemit të administrimit të rrezikut të likuiditetit me qëllim ruajtjen e efikasitetit të tij;

- c. shqyrtimin e raporteve lidhur me gjendjen e likuiditetit të bankës dhe përcaktimin e monitorimit e veprimeve të nevojshme për administrimin e rrezikut të likuiditetit;
 - d. përcaktimin e treguesve të likuiditetit dhe rishikimin periodik të kufijve të ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit;
 - e. hartimin e metodologjisë së kryerjes së *stress testeve* dhe procedurave për raportimin e rezultateve të gjeneruara prej tyre, si dhe raportimin periodik pranë Këshillit Drejtues mbi gjendjen dhe perspektivën e likuiditetit të bankës;
 - f. zgjidhjen e çdo problemi potencial të likuiditetit dhe siguron vazhdimësinë e operacioneve të bankes;
 - g. siguron kushtet për funksionimin efektiv të sistemit të kontrollit të brendshëm;
 - h. etj.
5. Krahas komitetit të administrimit të rrezikut të likuiditetit, banka mund të krijojë një strukturë të veçantë për administrimin e rrezikut të likuiditetit. Kjo strukturë është përgjegjëse për zbatimin operacional të politikës së administrimit të rrezikut të likuiditetit nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit ditor të rrezikut të likuiditetit.

Neni 6

Sistemi i kontrollit të brendshëm

1. Banka ka procedura të kontrollit të brendshëm të cilat sigurojnë integrimin e procesit të administrimit të rrezikut të likuiditetit brenda procesit të administrimit të rrezikut në teresi.
2. Sistemi i kontrollit të brendshëm për administrimin e rrezikut të likuiditetit përfshin minimalisht:
 - a. vendosjen e kufijve, në plotësim të atyre përcaktuar në këto rregullore, për kontrollin dhe administrimin e rrezikut të likuiditetit, të mbështetura mbi profilin e rrezikut të bankes dhe natyrën e operacioneve/veprimtarisë së saj;
 - b. monitorimin e përputhshmërisë me kufijtë e përcaktuar dhe raportimin mbi tejkalimet e mundshme të tyre;
 - c. kontrollin periodik të afatëve, saktësisë dhe plotësisë së të dhënave dhe supozimeve të përdorura për qëllime të matjes dhe monitorimit të likuiditetit;
 - d. aplikimin e masave për korrigjimin e dobësive të konstatuara;
 - e. zhvillimin e vazhdueshëm të metodave dhe metodologjive për matjen dhe kontrollin e rrezikut të likuiditetit;

- f. identifikimin e të gjitha rreziqeve të mundshme (rreziku i kredisë, i tregut, operacional etj..) dhe matjen e monitorimin e efektit të tyre mbi situatën e likuiditetit të bankës në kushte të caktuara;
- g. perputhshmerine me të gjitha ligjet, rregulloret dhe aktet e tjera nenligjore te Bankes se Shqiperise dhe rregullat e brendshme te bankes.

Neni 7

Sistemi i administrimit të informacionit

1. Banka krijon një sistem informacioni i cili siguron në kohë dhe në mënyrë të qendrueshme matje, monitorim, kontroll dhe raportim për procesin e vendimmarrjes me qëllim administrimin e rrezikut të likuiditetit.
2. Sistemi i informacionit duhet të sigurojë minimalisht:
 - a. matjen, kontrollin dhe monitorimin e likuiditetit të bankës në baza ditore dhe në periudha kohore të përcaktuara qartë;
 - b. matjen, kontrollin dhe monitorimin e likuiditetit të bankës për çdo monedhë të huaj, e cila ndikon në mënyrë të konsiderueshme likuiditetin e përgjithshëm të bankës në baza individuale dhe të agreguara;
 - c. monitorimin e përputhshmërisë me kufijtë e përcaktuar për ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit;
 - d. gjenerimin e të dhënave me qëllim llogaritjen e treguesve të likuiditetit dhe përgatitjen e formave të raportimit për nevoja të strukturave drejtuese të bankës dhe të gjithë personave të tjerë të përfshirë në procesin e administrimit të rrezikut të likuiditetit;
 - e. raportet e përqendrimit të depozitave dhe monitorim të qendrueshmërisë të tyre;
 - f. faqet elektronike (spreadsheet) për kryerjen e *stress-testeve* të likuiditetit dhe/ose analiza të skenareve.

Neni 8

Stress-testing

1. Banka administron likuiditetin jo vetëm në kushte/rrethana normale, por përgatitet për administrimin e tij dhe në kushte/rrethana të jashtëzakonshme.
2. Banka kryen në mënyrë periodike *stress teste* dhe/ose analiza të skenarëve, me qëllim identifikimin dhe matjen e ekspozimit të saj ndaj

rrezikut të likuiditetit në situata të jashtëzakonshme, analizen e ndikimit në fluksin e parave, aftësinë paguese afatshkurter dhe afatgjate, përgatitjen e bankes për të vepruar në kushte të jashtëzakonshme, si dhe vlerësimin e kapacitetit të saj për të rritur aktivitetin nepermjet identifikimit të burimeve me të favorshme të financimit.

3. Periodiciteti me të cilën banka kryen *stress testet* perzgjidhet prej saj në përputhje me madhësinë e veprimtarisë së bankes, ekspozimin e saj ndaj rrezikut të likuiditetit dhe rëndësinë e saj në sistemin bankar, me kusht që ky periodicitet të mos jetë më pak se dy here në vit. Në cdo rast, Banka e Shqipërisë mund t'i kërkojë bankes kryerjen e *stress testeve* në periudha me të shpeshta.
4. Rezultatet e *stress testeve* shqyrtohen nga Këshilli Drejtues i bankes dhe përdoren për:
 - përmirësimin e strategjive dhe politikave të administrimit të rrezikut të likuiditetit;
 - identifikimin e çështjeve kryesore për veprim lidhur me pozicionin e likuiditetit të bankës;
 - zhvillimin e planeve efektive të emergjencës.
5. *Stress-testet* e realizuara nga banka përfshijnë përdorimin e skenareve të vecantë bazuar në faktore të brendshme, si dhe të skenareve të bazuar në kushtet e tregut ku banka vepron dhe në faktore makroekonomik (faktore të jashtëm).
6. Skenaret për kryerjen e *stress testeve* mund të përfshijnë:
 - a) tërheqje masive të depozitave;
 - b) përkeqësim të mundshëm të aftësisë së kredimarrësve për të shlyer detyrimet që nënkupton përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredive;
 - c) pamundësi të konvertimit me lehtësi dhe pa humbje të konsiderueshme të aktiveve në *cash*;
 - d) mundësi të shlyerjes së parakohshme të detyrimeve në kushtet e ekzistencës së opsioneve kontraktuale që e mundësojnë këto shlyerje;
 - e) rrezikun operacional dhe shkallën e ndikimit të tij në rritjen e riskut të likuiditetit.
 - f) ndryshimet në kushtet ekonomike në sektoret ndaj të cilëve banka është ekspozuar dhe përkeqësimin e ekonomisë në teresi;
 - g) përkeqësim të funksionimit të tregjeve në të cilat banka operon dhe një reduktim të ndjeshëm të besimit në këto tregje;
 - h) *shock*-un e normës së interesit dhe atë të kursit të këmbimit;
 - i) efektin e ndryshimeve të ndjeshme në vlerën e aktiveve të bankes dhe/ose aktiveve të pranuar prej saj si garanci (kolateral);
 - j) kufizimin e pjesës apo të plote të financimit nga burimet kryesore të financimit;
 - k) ndikimin e zhvillimeve negative ekonomike në shkallë rajonale dhe globale.

- l) etj.
7. Banka konsideron supozimet e renditura në pikën 6 të këtij neni, të cilat janë udhëzuese për bankën, ndërkohë që banka përdor supozimet që përshtaten më mirë me kompleksitetin, profilin e rrezikut dhe rëndësinë e saj në sistemin bankar.
8. Banka përcaktonë metodologjinë për realizimin e *stress-testeve*, supozimet e përdorura si dhe veprimet në kunderpërgjigje të rezultateve të gjeneruara, e cila përfshin:
- a) zbatimin, analizen e skenareve të *stress testeve* dhe periodicitetin e realizimit të tyre;
 - b) realizimin e *stress testeve* për skenare individuale dhe skenare të kombinuara, në kushtet e ndodhjes së njëkohshme të disa skenareve;
 - c) dokumentimin dhe rishikimin në mënyrë periodike të supozimeve të përdorura për kryerjen e *stress testeve*;
 - d) formën dhe periodicitetin e raportimit të rezultateve të *stress testeve* në strukturat drejtuese;
 - e) veprimet që duhet të ndërmerren nga strukturat drejtuese apo/dhe strukturat e vecanta të ngarkuara për administrimin e rrezikut të likuiditetit mbështetur në rezultatet e *stress-testeve*.

Neni 9

Planet e emergjencës për administrimin e rrezikut të likuiditetit në situata të jashtëzakonshme

1. Banka zhvillon një plan emergjence për administrimin e rrezikut të likuiditetit në kushte të jashtëzakonshme (në vijim do t'i referohemi si plani).
2. Planin është pjesë e politikës së administrimit të rrezikut të likuiditetit dhe përmban:
 - a. ndarje të qartë të detyrave, kompetencave, përgjegjësi dhe vendimmarrjes në lidhje me aplikimin e planit;
 - b. treguesit e paralajmërimit të hershëm të përdorur si sinjalizues për zhvillimin e kushteve të jashtëzakonshme si dhe përcaktimin e personave brenda bankës, përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e këtyre treguesve (disa prej këtyre treguesve parqiten në aneksin 1);
 - c. kushtet në të cilat do të zbatohet plani;
 - d. përcaktimin e veprimtarive që duhet të ndërmerren, identifikimin e burimeve të mundshme të fondeve, nivelin e tyre dhe përparësitë në përdorim, si dhe përcaktimin e intervaleve kohore brenda të cilëve këto veprimtari duhet të ndërmerren;
 - e. metodën e komunikimit me depozituesit kryesorë, partnerët e biznesit, klientët e tjerë dhe publikun;

- f. kontakte të personave përgjegjës për implementimin e planit.
3. Banka e rishikon planin në mënyrë periodike, me qëllim marrjen në konsideratë të ndryshimeve të mundshme të kushteve të brendshme dhe të jashtme të operacioneve të bankës.
4. Në kushte të vështiresive ekonomiko-financiare, banka bashkepunon ngushtesisht me Bankën e Shqipërisë dhe shkëmben informacion të vazhdueshëm mbi gjendjen e saj financiare dhe veprimet e ndermarra për rikthimin e saj në parametra të kënaqshëm.

Kreu III

Tregues të matjes/monitorimit/administrimit të rrezikut të likuiditetit

Neni 10

Planifikimi dhe monitorimi i fondeve (flukseve) hyrëse dhe dalese

1. Banka planifikon dhe monitoron flukset hyrëse dhe dalëse të fondeve. Ky planifikim paraqet të gjitha llojet e flukseve hyrëse dhe dalëse, si ato aktuale dhe ato të pritshme, duke përfshirë dhe flukset hyrëse dhe dalëse për zërat jashtë bilancit të bankës.
2. Flukse hyrëse të pritshme konsiderohen hyrjet nga të gjitha llojet e depozitave, arkëtimet e kredive, shitjet e letrave me vlerë, përdorimet e huave ndërbankare, hyrjet nga zërat jashtë bilancit, (për instrumentat derivativë) dhe të gjitha hyrjet të cilat kanë mundësi të materializohen në të ardhmen.
3. Flukse dalëse të pritshme konsiderohen të gjitha daljet e fondeve për kreditë e aprovuara, blerjet e letrave me vlerë, akordimi i huave ndërbankare, pagimi i depozitave të klientëve, si dhe zërave jashtë bilancit, (për instrumentat derivativë) dhe të gjithat daljet e fondeve që pritet të materializohen për periudhën përkatëse.

Neni 11

Percaktimi dhe ruajtja e nje strukture te pershtatshme maturiteti

1. Banka monitoron strukturën e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve me qëllim identifikimin e *gap*-eve të mundshme të maturitetit.
2. Banka, për qëllime të matjes dhe monitorimit të *gap*-eve, shpërndan flukset hyrëse dhe dalese nga aktivet (të drejtat), pasivet (detyrimet) dhe zërat jashtë bilancit sipas shportave të maturitetit.

3. Banka perdor si date te arketimit te te drejtave daten me te fundit te mundshme dhe te shlyerjes se detyrimeve daten me te pare te mundshme për shportat e mëposhtme:
 - a) deri ne 7 dite
 - b) 7 dite deri ne 1 muaj
 - c) 1 muaj deri ne 3 muaj
 - d) 3 muaj deri ne 6 muaj
 - e) 6 muaj deri ne 12 muaj
4. Banka, krahas monitorimit te *gap*-ve sipas maturitetit te mbetur kontraktual, kryen ne menyre periodike monitorimin e *gap*-eve sipas maturitetit te mbetur te pritshem, duke perdorur per kete qellim supozime rreth flukseve te pritshme hyrese dhe dalese (probabilitetin e mbledhjes se te drejtave ne momentin kur ato maturohen, probabilitetin e tërheqjes së depozitave përpara maturimit, etj.).
5. Banka, në kuadrin e projektimit të flukseve të ardhshme të parasë, sigurohet qe supozimet e aprovuara të jenë të arsyeshme, të përshtatshme, të dokumentuara, të rishikuara në mënyrë periodike.
6. Banka në percaktimin e maturitetit te mbetur te pritshem, duhet:
 - a) te disponoje nje baze te dhenash te flukseve hyrese dhe dalese mbi te cilat jane mbeshtetur supozimet;
 - b) te rishikojë ne menyre periodike supozimet e perdorura me qellim pasqyrimin ne keto te fundit te ndryshimeve te mundshme ne kushtet e brendshme dhe te jashtme; si dhe
 - c) të sigurojë që supozimet te marrin ne konsiderate karakterin sezonal dhe ciklik te flukseve hyrese dhe dalese.
7. Banka mund te klasifikojë (grupoje) flukset sipas llojit te klientit, maturitetit, monedhes, sektorit, etj sipas metodologjisë së paërcaktuar për këtë klasifikim.
8. Inspektorët e Bankës së Shqiperise mund te kerkoje aplikimin e supozimeve te ndryshme apo te faktoreve korrigjues ne projektimin dhe monitorimin e flukseve sipas maturitetit te pritshem, kur ajo gjykon se keto veprime mundesojne nje pasqyrim me te mire te profilit te rrezikut te bankes.
9. Banka realizon analizën e *gap*-ve te likuiditetit duke u mbështetur kryesisht ne:
 - a. klasifikimin e aktiveve, pasiveve dhe zërave jashtë bilancit sipas shportave te maturitetit;
 - b. vleresimin e qendrueshmerise se depozitave bazuar ne te dhenat historike dhe rezultatet e *stress testeve*;

- c. vendosjen e kufijve per *gap*-et e likuiditetit;
- d. perlllogaritjen e *gap*-eve mbi baza ditore;
- e. parashikimin e *gap*-eve te likuiditetit ne te ardhmen;
- f. etj.

Neni 12

Monitorimi i burimeve te financimit dhe perqendrimit te tyre

1. Banka monitoron ne menyre periodike burimet e financimit me qellim ruajtjen e nje baze te diversifikuar te ketyre burimeve si dhe identifikimin e perqendrimeve te mundshme. Perqendrimet analizohen sipas burimit te financimit, llojit te financimit, tregut, perqendrimit gjeografik, sipas monedhes dhe maturitetit.
2. Monitorimi i burimeve te financimit dhe perqendrimit te tyre perfshin:
 - a) ruajtjen e marredhenieve te qendrueshme me depozituesit me te medhenj, bankat korrespondente, klientet e tjere te rendesishem si dhe me partneret e biznesit (duhet ripare);
 - b) percaktimin e qendrueshmerise se depozitave, duke marre ne konsiderate karakteristikat e depozituesve dhe llojin e depozites;
 - c) monitorimin e nivelit te diversifikimit te burimeve te financimit ;
 - d) monitorimin e levizjeve ne burimet e tjera te financimit.
3. Banka percakton dhe monitoron nivelin e perqendrimit te llogarive rrjedhese dhe depozitave pa afat ne monedhen vendase dhe ne monedhe te huaj.
4. Depozituesit e medhenj konsiderohen njezet depozituesit me peshen me te madhe ne totalin e depozitave te bankës.

Neni 13

Monitorimi i bazës së garancive (kolateralit) për qëllime të likuiditetit.

1. Banka administron pozicionet e saj të kolateralit, me qëllim identifikimin midis aktiveve të bllokuara për garanci dhe aktiveve të lira.
2. Administrimi efektiv i kolateralit synon përmbushjen e një tërësie kërkesash për kolateral lidhur me sigurimin e likuiditetit afatgjatë, afatshkurtër apo ndërditor.

3. Banka zotëron madhësi të mjaftueshme të kolateralit me qëllim përmbushjen e nevojave të pritshme apo të paparashikuara për huamarrje, mbështetur mbi profilin e saj të financimit.

Neni 14

Monitorimi i siguruesve të financimit me shumicë.

1. Banka vlerëson mundësinë e ripërsëritjes (rinegocimit) të linjave të kredisë dhe mundësinë që siguruesit e fondeve të reagojnë në mënyrë të njëjtë edhe në rrethana/kushte të jashtëzakonshme.
2. Banka konsideron mundësinë (probabilitetin) e shterimit të fondeve në rrethana të jashtëzakonshme.
3. Banka nuk mund të supozojë ripërsëritjen (rinegocimin) automatik të sigurt në masën 100 për qind të linjave me afat maturimi njëditor.

Neni 15

Normat e likuiditetit

1. Banka mban likuiditetin në një shume, strukture dhe raporte që e lejojnë ato të përmbushin detyrimet e saj dhe angazhimet e marra, sipas afateve kohore me një kosto të arsyeshme dhe me një rrezik minimal.
2. Banka krijon procedurat e nevojshme për matjen dhe monitorimin e flukseve neto të parase si dhe për monitorimin e likuiditetit në monedhat kryesore dhe në total.
3. Niveli i likuiditetit të bankës matet nga treguesi i likuiditetit, i cili llogaritet si raport i aktiveve likuide me pasivet afatshkurtra.
4. Banka llogarit dhe monitoron treguesin e likuiditetit sipas kufijve dhe afateve të përcaktuara si më poshtë:
 - a) minimumi 0.8 - për një ditë pune;
 - b) minimumi 0.9 - për tre ditë pune rradhazi;
 - c) minimumi 1 - për një muaj (treguesi për llogaritet si mesatare aritmetike e për llogaritur gjatë ditëve të punës).
5. Banka, në rast të mosrespektimit të këtyre normave, njofton Bankën e Shqipërisë jo më vonë se dita pasardhëse e punës. Raportimi përfshin informacion mbi ndryshimet e aktiveve dhe/ose pasiveve që kanë shkaktuar mungesë likuiditeti dhe veprimet e ndermarra nga banka për rikthimin e gjendjes së likuiditetit në nivelet e kërkuara.
6. Banka për llogaritet dhe sigurohet për respektimin në çdo moment të:

- a. treguesit te aktiveve likuide ndaj totalit te aktiveve ne nivelin minimal prej 20 për qind;
- b. treguesit te aktiveve likuide ne valute ndaj totalit te aktiveve ne valute ne nivelin minimal prej 30 për qind;
- c. treguesit te kredive ne valute ndaj depozitave ne valute ne nivelin maksimal prej 100 për qind.

7. Ne perlllogaritjen e aktiveve likuide përfshihen zërat e mëposhtëm:

- a. arka;
- b. llogarite me Banken Qendrore duke perfshire rezerven e detyrueshme deri ne gjysmen e mases se perdorimit te saj ;
- c. bonot e thesarit (perfshihen vetem 80% e bonove te thesarit) dhe obligacione te emetuara nga Banka e Shqiperise ose Qeveria e Republikes se Shqiperise;
- d. bono te tjera te pranueshme per refinancim me Banken Qendrore;
- e. llogarite rrjedhese ne bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare;
- f. depozita me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare me maturim te mbetur deri ne shtate dite;
- g. hua per bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare me maturim te mbetur deri ne shtate dite (perjashtohet llogaria 157 "hua te pakthyera ne afat ndaj bankave, institucioneve te kreditit dhe institucioneve te tjera financiare");
- h. letrat me vlere te tregtueshme/të vendosjes te emetuara nga qeverite qendrore dhe bankat qendrore me klasifikime nga agjencite nderkombetare te rating-ut ekuivalente me klasifikimin e S&P jo me pak se BBB⁻ (investment grade);
- i. letra me vlere te tregtueshme/të vendosjes te emetuara nga institucione financiare me vleresim nga agjencite nderkombetare te rating-ut ekuivalente me klasifikimin e S&P jo me pak se A⁺, i kryer jo me larg se gjashte muaj nga periudha raportuese;
- j. letra me vlere te tregtueshme/të vendosjes qe nuk jane te vleresuara, por te emetuara nga banka nderkombetare te zhvillimit te listuara në rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave";
- k. letra me vlere te investimit me maturim te mbetur deri ne nje muaj;
- l. letra me vlere te blera sipas marreveshjes se riblerjes me maturim te mbetur deri ne nje muaj;
- m. linjat e kredive të parevokueshme të aprovuara banks.

Aktivitet likuide përfshihen mbi baza neto, dukë përjashtuar interesat e perlllogaritura dhe duke zbritur fondet rezerve.

8. Ne perlllogaritjen e pasiveve likuide perfshihen zërat e meposhtem:
- a. veprimet me banken qendrore (perfshire llogarite rrjedhese, depozitat pa afat dhe depozitat me afat maturimi te mbetur deri ne shtate dite te marra nga banka qendrore, huamarrjet nga banka qendrore te rifinancuara nga nje institucion financiar nderkombetar dhe ato jo te financuara nga nje institucion financiar nderkombetar me maturim te mbetur deri ne shtate dite, si dhe llogarite e tjera me banken qendrore me maturim te mbetur deri ne shtate dite);
 - b. bono thesari dhe bono te tjera te pershtatshme per rifinancim me banken qendrore;
 - c. llogari rrjedhese me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare;
 - d. depozitat nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare me maturim te mbetur deri ne shtate dite;
 - e. hua marre nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare maturim te mbetur deri ne shtate dite;
 - f. llogari te tjera me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare me maturim te mbetur deri ne shtate dite;
 - g. llogari rrjedhese dhe depozitat pa afat nga qeveria shqiptare dhe administrata publike si dhe depozitat me maturim te mbetur deri ne shtate dite;
 - h. letra me vlere te shitura sipas marreveshjes se anasjellte te riblerjes me maturim te mbetur deri ne nje muaj;
 - i. 30 për qind e llogarive rrjedhese me teprice kreditore;
 - j. 30 për qind e depozitave pa afat;
 - k. 10 për qind e depozitave me afat;
 - l. 5 për qind të garancive dhe të angazhimeve të tjera (jashtë bilanci);
 - m. 20 për qind të linjave të kreditit të aprovuara (të papërdorura), por të parevokueshme.
9. Banka, përvec treguesve të përcaktuar në pikën 4 dhe 6 të këtij neni, monitoron dhe percakton kur gjykon te nevojshme kufij te brendshme edhe per treguesit e meposhtem:
- a. *gap*-i kumulativ deri ne nje muaj ndaj aktiveve likuide;
 - b. *gap*-i kumulativ deri ne tre muaj ndaj aktiveve likuide;
 - c. kredi ndaj depozitave (të perlllogaritur ne total si dhe te ndare ne leke dhe valute);
 - d. kredi ndaj depozitave dhe linjave të financimi;
 - e. raporti i aktiveve likuide ndaj totalit te depozitave;
 - f. raporti i *cash*-it ndaj pasiveve afatshkurtra;
 - g. raporti i likuiditetit sipas shportave te maturitetit;
 - h. raporti i transformimit te maturimit te burimeve afatshkurtra ne investime afatgjata;

- i. treguesi i perqendrimit te depozitave (sipas llojit te depozituesit, monedhes, sektorit, etj.) si dhe qendrueshmeria e tyre;
- j. interesat mesatare te ponderuara te aktiveve dhe pasiveve;
- k. kosto mesatare marxhinale e likuiditetit;
- l. kufijtë e vendosjeve prane bankave te tjera;
- m. parashikimi i nevojave te ardhshme per likuiditet (aktive likuide te disponueshme – aktive likuide te kerkuara).

KREU IV

Mbikëqyrja dhe raportimi

Neni 16

Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse, parandaluese dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

Aneksi 1

Treguesit e paralajmerimit të hershëm

Lista e mëposhtme paraqet disa nga treguesit e paralajmerimit të hershëm që duhet të trajtohen me kujdes nga bankat. Kjo listë nuk është kufizuese por orjentuese.

1. rritje e shpejte e aktiveve vecanerisht kur kjo rritje financohet me burime jo të qendrueshme;
2. rritje e përqendrimit të aktiveve dhe/ose të detyrimeve;
3. rritje/ulje e madhe e pozicioneve neto në blerje/shitje sipas monedhave;
4. rënie e maturitetit mesatar të ponderuar të detyrimeve;
5. thyerje e vazhdueshme e kufijve të brendshëm apo atyre rregullator të përcaktuar për treguesit e likuiditetit;
6. trende negative dhe/ose rritje e rreziqeve të lidhura me një linjë produkti dhe/ose biznesi;
7. përkeqësim i ndjeshëm në të ardhurat e bankës, cilësinë e aktiveve të saj dhe situatën e përgjithshme financiare;
8. publicitet negativ;
9. përkeqësim në vlerësimet e rating-ut të bankës;
10. rënie në çmimin e aksioneve dhe/ose rritje e kostos së borxhit;
11. rritje e kostove të financimit me shumicë ose me pakicë;
12. kufizim apo shterim i linjave të kredive nga bankat korespondente;
13. rritje në ritmin e tërheqjes së depozitave;
14. rritje në ritmin e tërheqjeve përpara maturimit e certifikatave të depozitave;
15. vështirësi në gjetjen e fondeve afat gjata;
16. etj.